PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE

- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Arkitekt**
- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Urbanist**
- **Program i studimit i ciklit të parë, Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn**

Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.3
b) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1
c) Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse. Studenti që transferon studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dorëzon të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse si dhe listën e notave me kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer
d) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur
e) Kopje të njëhsuar me origjinalin të diplomës së maturës shtetërore/dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në republikën e shqipërisë përpara vitit 2011
f) Kopje të dokumentit të identifikimit
g) Dy fotografi personale
h) Kopje të mandatpagesës

Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues). kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

a) *Emrin, atësinë, mbiemrin:* ***b)*** *datëlindjen:* ***c)*** *vendlindjen:* ***d)*** *shtetësinë:* ***e)*** *numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse:*

f) *emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi:*

g) *ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë:* ***h)*** *numrin personal të identitetit;*

i) *datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja:* ***j)*** *emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës:*

k) *ciklin dhe formën e studimit:* ***l)*** *datën e ndërprerjes së studimeve.*

<u>Shënim:</u> Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.